



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4920/1 Prot.

Tiranë, më 01.08. 2024

UDHËZIM

Nr. 18, datë 01.8. 2024

“PËR

**DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË 4.11.2022, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE AFATEVE TË APLIKIMIT, SI DHETË PROCEDURAVE TË PËRCAKTIMIT TË MASËS DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE ATYRE QË NDJEKIN PROGRAME STUDIMI QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 6, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar dhe Urdhër nr.113, datë 26.03.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, Znj.Ana Kapaj”, i ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Në udhëzimin nr. 30, datë 04.11.2022, i ndryshuar, të bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 2/1, ndryshohet, si më poshtë:

*“2/1. Përcaktimi i programeve prioritare të studimit dhe kuotat e financimit për këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë bëhet nga komisioni ad hoc i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas përcaktimeve të pikës 6.1, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar dhe i dërgohen AKFAL. AKFAL njofton kuotat për çdo IAL publike dhe shpërndan fondin e transferuar për këtë qëllim secilit prej tyre.”.*

b) Pika 5, ndryshohet, si më poshtë:

*“5. Përzgjedhja e studentëve përfitues sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të këtij udhëzimi, bëhet sipas përcaktimeve në vendimin nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të*

*Ministrave, të ndryshuar. Vendimi i institucioneve publike të arsimit të lartë për përzgjedhjen e studentëve përfitues, në programet prioritare të studimit, i njoftohet Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë. Pas marrjes së vendimeve të IAL-ve publike, AKFAL-i harton listën përfundimtare dhe ia përcjell ministrisë përgjegjëse për arsimin. Bazuar në këtë listë, ministria përgjegjëse për arsimin akordon fondin për çdo institucion publik të arsimit të lartë.”.*

c) Pika 10, ndryshohet, si më poshtë vijon:

*“10. Për studentët përfitues, AKFAL-ja do të bëjë verifikimin e plotësimit të kërkesave të pikës 4, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar. Për këtë qëllim, IAL-të duhet të depozitojnë, brenda muajit tetor, vërtetimin për shlyerjen e të gjithë detyrimeve të vitit paraardhës dhe/ose listën e notave, sipas përcaktimeve të pikës 4, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar. Në rast të mosplotësimit të kërkesave të pikës 4, të vendimit nr. 386, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar., studenti e humb të drejtën e përfitimit të mbështetjes financiare për vitin akademik pasardhës. Në këtë rast, AKFAL-ja njofton studentin, institucionin publik të arsimit të lartë dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin.”*

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSMINISTËR**

**ANA KAPAJ**

